

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA E PODUJEVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	615-22-2868-5-2-1
Nr i brendshëm	61522046521

Sa i përket tenderit për: **"Investime në infrastrukturën e turizmit"**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"EING COM" SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Fsh Dumosh – Podujevë, 11000

(Vendi, Kodi postar)

+383 49 263 052

(Numri Telefonit)

Eljesah PODVORICA

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@eing-ks.com

(Adresa elektronike)

06.06.2022

(Data e parashtrimit të kërkesës)



2. Identifikimi i avokatit

Ankesa parashtrohet nga përfaqësuesi i autorizuar i OE "EING COM" SH.P.K.

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- 07.04.2022 – Data e publikuar e Njoftimit për Kontratë në KRPP sa i përket tenderit me titull: **" Investime në infrastrukturën e turizmit"** me nr. prokurimi: **615-22-2868-5-2-1**
- Në këtë rast kemi të bëjmë me procedurë të hapur ku kriter për dhënien e tenderit është Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.
- 27.04.2022 – sipas Njoftimit për Kontratë, - Afati i fundit për Dorëzimin e Tenderëve.
- 19.05.2022 - Letrës Standarde për Tenderuesin e pasukseshem OE: "EING COM" SH.P.K
- 19.05.2022 OE: "EING COM" SH.P.K- Kërkesë për qasje në dokumente zyrtare të OE të propozuar për dhënie dhe OE pjesmarrës në këtë aktivitet.
- 20.05.2022 OE ankues parashtron këtë Kërkesë për Rishqyrtim tek AK për kundërshtimin të Njoftim për vendimin e AK-së.
- 24.05.2022 AK pezullon aktivitetin e prokurimit.
- 25.05.2022 Ak refuzon si të pa bazuar kërkesën për Rishqyrtim nga ana jonë.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Nuk ka vërejtje

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti kontraktues / komisioni i vleresimit ka bërë shkelje me bazë ligjore materiale të zbatueshëm – legjislacionin/rregullat e prokurimit publik, duke shkelur parimin e ligjshmërisë,

parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, parimin e pavarësis dhe paanësisë në vendimarrje, dhe atë bazuar në konsiderata tjera përveq atyre të lejuara me ligj, konsiderojmë se ka vepruar në shkelje të dispozitave materiale të LPP-së, rregullave të prokurimit të cekura si në vijim:

1. Neni 1 par.2 (Qëllimi) i LPP-së nr.04/L-042; lidhur me parimet bazike nga neni 4.4 i RrUOPP;
2. Neni 7 par.1, 2 dhe 4 (Barazia në trajtim/Jo-diskriminimi) i LPP-së nr.04/L-042 lidhur me parimet bazike nga neni 4.4 i RrUOPP;
3. Neni 59 par. 2 dhe 4 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve) i LPP-së nr.04/L-042, lidhur me nenin 40 dhe 41 pika 3 të RrUOPP;
4. Neni 60 par. 1 (Kriteret për dhënie të kontratës)
5. Neni 69 (Aftësia teknike dhe/ose profesionale)

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Me datë: 19.05.2022 kemi pranuar Letrën Standarde për Tenderuesin e pasukseshëm.

Po në këtë datë ne kemi kërkuar qasje e dokumentacionin tenderit të OE të propozuar për dhënie dhe OE pjesmarrës në këtë aktivitet. Qasja na është mundësuar me datë: 20.05.2022 gjatë orarit të punës. Në qasje ne kemi kërkuar që të na jepet kopje e materialit të OE të propozuar për dhënie të kontratës, OE pjesmarrës si dhe raporti i vlerësimit nga ana e komisionit.

Gjatë analizës të dokumentacionit të dorëzuar të tenderit nga ana e OE të propozuar për kontratë ne kemi vërejtur se komisioni i vlerësimit pranë AK "KOMUNA E PODUJEVËS" sh.a. ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-se dhe rregullave të UOPP-se.

Ne vijim po ju paraqesim në mënyrë të detajuar faktet dhe argumentet të cilat AK nuk i ka respektuar me rastin e vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit të tenderëve.

Faktet dhe argumentet të cilat nuk i ka plotësuar O.E. N.N.T "BINI" SH.P.K. i rekomanduar për kontratë:

Andaj në vështrim të gjendjes faktike dhe në vështrim të bazës ligjore, shkeljet konsistojnë në faktet dhe rrethanat e cekura siç janë pasqyruar në objektin e pretendimeve dhe atë për arsyet si në vijim:

Pretendimi Nr. 1

Është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme - 1 (Një) Menaxher i projektit - Inxhinier i diplomuar ose master i Ndërtimtarisë (drejtimi konstruktiv), minimumi 3 vite përvojë pune pas diplomimit.

Dëshmia e kërkuar: Lista e stafit profesional së bashku me diplomat, CV-të, kontratat e punës ose marrëveshja për bashkëpunim në këtë projekt, dëshmitë mbi përvojën e punës. Për ti plotësuar kërkesat duhet të ofrohen edhe këto dëshmi së paku një letër referencë nga punëdhënësi ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme **si dhe vendimet e nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania për caktimin në pozitat e kërkuara.**

O.E. nuk ka ofruar dorëzuar vendimin për caktimin e menaxherit të projektit sipas kërkesës së AK-së, sepse vendimi i dorëzuar nuk është nënshkruar nga ana e menaxherit z.Arben Mazreku por vetëm nga kompania, andaj OE i propozuar për dhënie nuk i plotson kriteret për shpërbllim me kontratë.

P.S. Gjeni vendimin e panelit shqyrtues për lënden 231/21 të datës: 30.03.2021 për të njëjtin pretendim ankimor.

Pretendimi Nr.3

Është kërkuar: b) Menaxher i projektit - Inxhinier i dip. ose Master i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, me së paku 10 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit). Të caktohet me shkresë dhe të jetë i nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania dhe i vërtetuar nga noteri.

G.O.E. nuk ka ofruar deklaratën për menaxherin e projektit sipas kërkesës së AK-së, ku kërkesa ka qenë që deklarata të jetë e nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania dhe i vërtetuar nga noteri.

Faqe 77 nga 100

Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtuese pas shqyrtimit dhe analizimit të pretendimit të OE ankuesit për grupin e OE të rekomanduar, sqaron se në ofertën e grupit të OE të rekomanduarit gjendet Vendimi mbi caktimin e menaxherit të projektit, mirëpo është e nënshkruar vetëm nga njëra palë, në këtë rast nga grupi i OE të rekomanduar dhe po ashtu nuk është e noterizuar, andaj pretendimi i OE ankuesit gjendet i bazuar.

Arsyetimi i AK mbi këtë pretendim është për keqardhje sepse me qdokusht është munduar ta shperblej me kontratë një OE i cili nuk i plotson kërkesat e cekura ne FTD e për me tepër edhe elaborimin nga ana e AK i cili është kundërtëhënese me vetë kerkesat e cekura nga vet AK.

Pretendimi Nr. 2

Është sqaruar: Gjatë fazës së ofertimit AK në platformen e-prokurimi ka ngarkuar sqarime shitesë për OE ku ka cekur sikurse në vijim:

Pyetja nga OE:	Përgjigje:
<p>Sipas paramasës: PUNET Furnizimi, transporti dhe montimi i fushëlojave multifunkionale të kategorizuara sipas moshave, siç është e prezentuar në Këndin e lojërave I.</p> <p>Këtu përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Luhatëse rrotulluese , copë 1; -Luhatëse me suse , copë 1; -Luhatëse për hendikep , copë 1; -Shtrëpiza , copë 1; -Eksulibri , copë 1; -Luhatëse për dy persona , copë 2; -Spirale , copë 1; -Topogani , copë 1; <p>Në pozicion përfshihet bazamenti i lojërave, rëra, bulonat si dhe të gjitha elementet e nevojshme deri në finalizim.</p> <p>Të gjitha punët duhet të përfundohen sipas standardeve dhe udhëzimeve të dhëna nga organi mbikëqarës.</p> <p>Produkti duhet të plotësojë standardet sipas DIN ose standarde të ngjashëm të EU. Shiko foton</p> <p>TE FUSHËLOJAVE MULTIFUNKSIONALE</p> <p>Pyetja jone eshte:</p> <p>A duhet te ofrohen me ofertë certifikata/atesto-katalogje me specifika per lodrat e kerkuara duke u referuar kërkes se paramasës.</p>	<p>Pasi që paramasa dhe parallogaria është pjesë e dosjes së tenderit të gjithë OE duhet ti referohen specifikave të cilat kërkohen me ofertë, duke pas parasyshë që lodrat duhet të jenë sipas standardeve për përdorim dhe siguri të tyre.</p>

OE pjesmarrës nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi se do ti dorëzoj produktet sipas specifikave teknike të cilat janë kërkuar të ofrohen me ofertë andaj ky OE i propozuar për dhënie nuk i plotson kriteret e cekura nga AK për shpërblim me kontratë.

-----perfundim i pretendimeve ankimore-----

Andaj arsyet dhe faktet e paraqitura më lartë, dhe për shkak që mos të dëmtohet interesi publik nga mungesa e marrjes së shërbimeve me kohë, dhe në anën tjetër që të ndalet dhe parandalohet dëmi serioz që është shkaktuar në drejtim të parashtruesit të ankesës duke ia mohuar të drejtën ligjore që të shpërblehet me kontratë pasi nuk ka asnjë bazë ligjore që të veprohet ndryshe, kërkojë që pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe provave të paraqitura, Organi Shqyrtues i Prokurimit të merr vendim me të cilin:

- I. **APROVOHET** si e bazuar ANKESA e OE "EING COM" sh.p.k.;
- II. **ANULOHET** Njoftimi i Vendimit të Autoritetit Kontraktues për Njoftim për vendimin e AK-së të datës: 25.05.2022
- III. **Lënda të kthehet në RIVLERËSIM** duke marrë në konsiderat të gjitha gjetjet të cilat janë lartëcekur dhe me rastin e rivlersimit të jete ne harmoni me kërkesat ligjore si dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Operatori Ekonomik "EING COM" sh.p.k. në mbrojtje të interesave të tij ekonomike dhe ligjore, rrjedhimisht në rast të vazhdimit të veprimeve kundërligjore do të veprojë me të gjitha mjetet ligjore të lejuara, dhe Kërkesës për kompensimin e dëmeve, duke përfshirë edhe fitimin e humbur.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Ankesës i bashkangjiten ne kopje dokumentet, faktet, provat e konstatuara me larte.

PRETENDIMI 1



**VENDIM
PËR CAKTIMIN E MENAXHERIT TE PROJEKTIT**

Duke marrë parasysh nevojën për angazhimin e udhëheqësve të punimeve si edhe duke pas parasysh përvojën dhe përgatitjen e tyre profesionale stafi udhëheqës N.N.T "BINI" shpk, merr vendim që në rast se fitohet tenderi me titull:

"Investime në infrastrukturën e turizmit), Numri i Prokurimit: **615-22-2868-5-2-1"**, punët rreth implementimit të projektit do t'i udhëheqin inxhinierët e caktuar me këtë vendim, të cilët me përvojën e tyre disa vjeçare kanë menaxhuar realizimin e punimeve të tilla në objekte të ndryshme.

Sipas këtij vendimi ndërmarrja angazhon për menaxher kryesor të realizimit të këtij projekti inxhinierin e Ndërtimit:

- Arben **MAZREKU** inxhinier i diplomuar i ndërtimit (drejtimi konstruktiv) – menaxher i projektit

Si dhe stafi tjerë profesional në kuadër të ndërmarrjes inxhinier dhe teknikë me përvojë, të dhënë me dokumente përkatëse dhe CV në dosje.

Këtij vendimi i bashkëngjiesim edhe kopjet e diplomave, kontratave të punës, CV-të dhe dokumente tjera.

N.N.T "BINI" shpk



Pretendimi Nr.3

Është kërkuar: b) Menaxher i projektit - Inxhinier i dip. ose Master i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, me së paku 10 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit). Të caktohet me shkresë dhe të jetë i nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania dhe i vërtetuar nga noteri.

G.O.E. nuk ka ofruar deklaratën për menaxherin e projektit sipas kërkesës së AK-së, ku kërkesa ka qenë që deklaratat të jetë e nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania dhe i vërtetuar nga noteri.

Faqe 77 nga 100

Paneli Shqyrtues konform ekspertës shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të pretendimit të OE ankuesit për grupin e OE të rekomanduar, sqaron se në ofertën e grupit të OE të rekomanduarit gjendet Vendimi mbi caktimin e menaxherit të projektit, mirëpo është e nënshkruar vetëm nga njëra palë, në këtë rast nga grupi i OE të rekomanduar dhe po ashtu nuk është e noterizuar, andaj pretendimi i OE ankuesit gjendet i bazuar.

PRETENDIMI 2

Pyetja nga OE:

Përgjigje:

Sipas paramases: PUNET Furnizimi, transporti dhe montimi i fushelobjave multifunkionale të kategorizuara sipas moshave, siç është e prezantuar në Këndin e lojërave 1.

Këtu përfshihen:

- Lulatëse rrotulluese , copë 1;
- Lulatëse me sustë , copë 1;
- Lulatëse për hendikep , copë 1;
- Shqipëza , copë 1;
- Ekuilibri , copë 1;
- Lulatëse për dy persona , copë 2;
- Spirale , copë 1;
- Topogani , copë 1;

Në pozicion përfshihet bazamenti i lojërave, rëra, bulonat si dhe të gjitha elementet e nevojshme deri në finalizim.

Të gjitha punët duhet të përfundohen sipas standardeve dhe udhëzimeve të dhëna nga organi mbikqyës.

Produkti duhet të plotësojë standardet sipas DIN ose standarde të ngjashëm të EU. Shiko foton **7E FUSHELOJAVE MULTIFUNKSIONALE**

Pyetja jone eshte:

A duhet te ofrohen me oferte certifikata/ateste/katalogje me specifika per lodrat e kerkuara duke u referuar kereses se paramases.

Pasi që paramasa dhe paralogaria është pjesë e dosjes së tenderit të gjithë OE duhet ti referohen specifikave të cilat kërkohen me ofertë, duke pas parasyshë që lodrat duhet të jenë sipas standardeve për përdorim dhe siguri të tyre.